



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 1, datë 13.01.2022

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin Janar, që zhvillohet me mjete të komunikimit elektronik (aplikacioni SKYPE).

Orari i fillimit të mbledhjes : 09:05

Data e mbajtjes së mbledhjes : 13.01.2022

Mbajtja e mbledhjes : Online aplikacioni SKYPE

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Rradhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari z.Gentian Kallmi dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Mirmëngjes të gjithëve !

Të nderuar Këshilltarë! I nderuar Zëvendëskryetar ! Të nderuar pjesmarrës !

Uroj që të jeni mirë të gjithë ju dhe familjet tuaja.

E deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë rradhe të parë për vitin 2022 të Këshillit Bashkiak Durrës me mjete të komunikimit elektronik.

Ftoj Sekretaren e Këshillit të bëj prezencën online.

Dorina Milja: Përshëndetje të gjithëve! Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... prezent...ok....etj....deri te Morena Boja..... (jo për momentin.... citon E.Marku asistentja teknike)

Atëherë Kryetar ke 29 këshilltarë që u dëgjuan online ke dhe 7 vota me email.

(Hyn me vonesë Indrit Cërloj dhe Etleva Budini që votuan në chat dhe votoi me email gjatë mbledhjes Morena Boja, kështu që janë 31 këshilltarë online dhe 8 email. Gjithsej 39 vota në mbledhje)

Ani Dyrmishi: Faleminderit. Atëherë kuorumi është i pranishëm. Siç jemi njoftuar të gjithë me email, sot kemi 1 pikë në rendin e ditës e cila është:

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË EMËRTIMIT TË RRUGËS “ERIH MARIA REMARK” NË RRUGA “BENEDIK BRAHJA”
---	--

Kemi ndonjë koment për rendin e ditës?....

Atëherë nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?(ndërkohë qetësi, po votohet në chat)...

Kundra?Apstenim?.....

Ju lutem votoni të gjithë kush nuk ka votu.....

Ju lutem të votojë kush nuk ka votuar ende.

Eni mund të ma konfirmosh votimin?

Eneida Marku (asistenca teknike) : Janë ende në votim e sipër kolegët.

Eneida Marku (asistenca teknike) : Votimi përfundoi. Me të gjitha votat pro.

Ani Dyrmishi : Atëherë faleminderit . Me të gjitha votat pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës parë** dhe të vetme të rendit të ditës, ia kaloj fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Roshi.

Alneida Roshi : Faleminderit Kryetar !

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike propozon në mënyrë unanime pikën e parë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, znj.Jolanda Mustafaraj.

Jolanda Mustafaraj : Përshëndetje të gjithëve.

Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik dje ra dakort për ndryshimin e emërimit të rrugës “Erih Maria Remark” në rruga “Benedik Brahja”

Ani Dyrmishi : Faleminderit!

Kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve ?.....

Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim . Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

Dorina Milja : Erdhi dhe një email, kështu që ke 8 email.

Ani Dyrmishi : Kundra? Apstenim?..... Ju lutem të votoj kush nuk ka votuar.

Eneida Marku (asistenca teknike) : I lutem z.Çiraku të shpreheni për pikën 1.

Ani Dyrmishi : Ju lutem, kush nuk ka votuar.....

Eni, të lutem ma konfirmon votimin?

Eneida Marku (asistenca teknike) : Po, votimi përfundoi me të gjitha votat pro.

Ani Dyrmishi: Atëherë më të gjitha votat pro miratohet pika 1 dhe e vetme e rendit të ditës.

Duke Ju falenderuar të gjithëve për pjesëmarrjen, do të njoftoheni për mbledhjen e ardhshme nga ana e Sekretares së Këshillit me rrugë elektronike.

Atëherë mbledhjen e deklaroj të mbyllur dhe një ditë të mbarë.

Ky procesverbal mbyllet me nr.rendor 3(tre) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funkcionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :	ANI DYRMISHI
Sekretare e Këshillit Bashkiak :	DORINA MILJA
Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :	ELIO JANI
Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :	ETLEVA VELÇANI